



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA-KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 02-111/01-0008530/26
Data.
Data. 05.03.2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Duke u bazuar në nenin 78, paragrafi 2, nenin 80, nenin 81 dhe nenin 82, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë; në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës; në nenin 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar; në nenin 5, pika c, të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës; në Udhëzimin Administrativ të MASHTI Nr. 05/2021 si dhe në nenin 8, 9 dhe 10 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS ME AFAT TË CAKTUAR

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori i Institucionit
Lloji i pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik
Orët e punës: 40 orë në javë
Periudha e kontratës: Me kohë të caktuar

Nr	Niveli	Pozita e punës	Vendi	Koeficienti	Numri i pozitave
1	IP	Edukatore për grupmoshën 0-3 vjeç	Skenderaj	6.1 – E21	1

Përshkrimi i detyrave të punës:

Të realizoj planprogramin edukativ për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj/të punës;

Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin edukativ 0-3 vjeç;

Të zbatojë metodologjitë e reja edukative dhe në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.

Të tregojë respekt dhe të silllet me drejtësi, barazi dhe pa dallime me bashkëpunëtorët të cilët punojnë;

Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit, të cilit i raporton, dhe t'i kryejë detyrat që mund tua caktojë ai/ajo;

Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Të mos kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç drejtorit të institucionit parashkollor dhe DKA-së;

Të mos e shfrytëzoi pozitën e punës për interesa private në dobi të ndonjë pale të tretë, përfshirë edhe familjen, shoqërinë apo miqësinë e tij.

Të ushtrojë maturi maksimale lidhur me të gjitha çështjet e punës. Përfshirë, ruajtjen e informatave (nëse nuk janë publike), të cilat lidhen me procesin e punës dhe raporteve të krijuara prej saj, duke mos komunikuar këto informata me asnjë person fizik dhe juridik, përveç kur informatat e tilla janë të parapara në kuadër të detyrave apo autorizimit nga zyrtari të cilit i raporton.

Të mbaj orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore. I punësuar i është obliguar të respektojë kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar me rregulloren e brendshme të shkollës dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore.

I punësuar i nuk do të kryejë punë apo detyrë tjetër, me orar të plotë, nëse puna e tillë, bie ndesh me aktet përkatëse

ligjore dhe nënligjore, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga DKA- ja ose përfaqësuesit të saj.
Puna do të monitorohet dhe të vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të fëmijëve, sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës;
Punë dhe detyra të tjera shtesë të caktuara nga drejtori i institucionit parashkollor dhe detyra të përcaktuara në legjislacionin në fuqi të arsimit parauniversitar.

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojnë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Kërkesat e përgjithshme formale:

Kriteret e kualifikimit për Edukatore për grupmoshën 0-3 vjeç:

- Fakulteti i Edukimit - programi katërvjeçar i nivelit bachelor për edukimin në fëmijëri dhe hershme 0-3 vjeç;
- Shkolla e mesme e mjekësisë – drejtimi infermiere – edukatore;
- Shkolla e mesme e mjekësisë – drejtimi i pediatriisë
- Shkolla e mesme e mjekësisë – drejtimi mami;
- Shkolla e mesme e mjekësisë së përgjithshme;

Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë – nr 13);
- Vërtetimin e përvojës në mësimdhënie (**nëse ka**).
- Diplomat e kualifikimit, duhet të jenë të noterizuara;
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Portfolio personale dhe profesionale me përmbledhjen e punës.
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor, me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;

Mënyra e vlerësimit:

- a. Testi me shkrim
- b. Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave publikohen në webfaqen e <https://kk.rks-gov.net/skenderaj/category/konkurseynjoftimet/> (konkurset);

Fillimi i punës për vendet e caktuara si me lartë bëhet në varësi të lirimit real të vendit të punës; Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të shpallen në web-faqen zyrtare të Komunës të Skenderajt;

I. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur **5 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më:05.03.2026 deri më datën 09.03.2026
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në objektin e komunës, kati i parë, sporteli Nr.13;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim.
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Nëse aplikohet për dy pozita (Vend i lirë/Zëvendësim), kandidatët duhet të dorëzojnë dy aplikacione të veçanta;
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional siç specifikohet me legjislacionin në fuqi.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

